



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 256 Akti

Nr. 241 Vendimi
Tiranë, më 26.2.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Anëtare
Genta Tafa (Bungo)	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar z. Hans Kijlstra, më datë 24.2.2020, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve (Ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Irena Gjoka**, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, sot Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, aktualisht me funksionin gjyqtare në Gjykatën e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 16.1.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët znj. Genta Tafa (Bungo), znj. Valbona Sanxhaktari dhe z. Roland Ilia. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Genta Tafa (Bungo).

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 18.1.2020, u caktua me mirëkuptim kryesues z. Roland Ilia, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Gjoka.

5. Procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ për subjektin Irena Gjoka, nisi referuar pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektoratit i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- (i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë dhe;*
- (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin² për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të trija kriteret: atë të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.07.2018.

² Raporti me nr. *** prot., datë 2.11.2017.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 02.07.2019.

vlërësimit të aftësive profesionale, në datën 5.2.2020, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të trija kriteret për subjektin e rivlërësimit, znj. Irena Gjoka; (ii) njoftimin e subjektit të rivlërësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlërësimit, në datën 6.2.2020, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlërësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 7.2.2020 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 17.2.2020.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlërësimit në seancë dëgjimore⁴.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlërësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 19.2.2020.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlërësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më 24.2.2020, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Hans Kijlstra.

19. Subjekti i rivlërësimit, znj. Irena Gjoka, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlërësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlërësimit, znj. Irena Gjoka, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Znj. Irena Gjoka ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlërësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlërësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

20.1 Subjekti i rivlërësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlërësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlërësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. ***, datë 19.02.2020.

21.5 Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017⁵ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumente të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

24. Apartament⁶, me sipërfaqe banimi 71 m², adresa: Rr. “****”, Tiranë;

(i) vlera e deklaruar 45.885 euro; **(ii) pjesa takuese:** 100%; **(iii)** Subjekti ka deklaruar se e ka fituar këtë pasuri nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.10.2005. Apartamenti është porositur në datën 6.10.2005, kaluar pronësia në vitin 2007 me kontratën e shitblerjes nr. *** kol., nr. *** rep., datë 12.2.2007.

24.1 Burimi i deklaruar i pasurisë: **(i)** të ardhurat nga paga, të kursyera gjatë viteve, si dhe **(ii)** huaja prej 2.000.000 lekë, marrë të tretëve.

⁵ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarsisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlersimit të subjekteve të rivlersimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlersimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

⁶ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës: (1) Kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.10.2005; (2) Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2007; dhe (3) Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 25.4.2007.

🚩 Hetimi⁷ i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri

24.2 Nga hetimi rezulton se më 6.10.2005, subjekti i rivlerësimit, me kontratë sipërmarrjeje nr.***, ka porositur një apartament me sipërfaqe totale ndërtimi 80.5 m². Çmimi i apartamentit është caktuar në shumën 45.885 euro, i cili në bazë të kontratës së sipërmarrjes rezulton të jetë i likuiduar plotësisht me nënshkrimin e kontratës.

24.3 Në datë 12.02.2007 është lidhur kontrata e shitblerjes nr. *** për këtë apartament. Sipërfaqja e apartamentit në këtë kontratë është 71 m², duke mos u përfshirë sipërfaqja e përbashkët.

24.4 Nga ZVRPP-ja Tiranë konfirmohet se subjekti ka në pronësi apartament, me sipërfaqe 71 m², me numër pasurie ***, zona kadastrale ***.

🚩 Hetimi/Analiza ligjore-financiare për burimin e krijimit të pasurisë së llojit “apartament”

24.5 Referuar deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, **subjekti ka deklaruar si burim të krijimit të pasurisë “apartament”, si më poshtë:**

- i. *të ardhurat nga paga, të kursyera gjatë viteve;*
- ii. *hua në shumën 2.000.000 lekë, marrë të tretëve.*

Analiza e kryer nga Komisioni, në lidhje me të ardhurat nga paga

24.6 Referuar DVP/2005, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka bërë:

- i. *Tërheqje depozite, “Banka e Kursimeve”, shuma 93,000 lekë;*
- ii. *Tërheqje depozite “Tirana Bank”, shuma 800,000 lekë;*
- iii. *Kursime për vitin 2005, në shumën 15.000 euro;*
- iv. *Tërheqje dhe mbyllje e depozitës në “Intesa San Paolo Bank”.*

24.6.1 Në lidhje me shumën 15, 000 euro, subjekti, bazuar në procesverbalin e datës 2.10.2014 të ILDKPKI-së ka deklaruar se kjo shumë e ka burimin nga: *“Një pjesë ka qenë kursim i atij viti, një pjesë ka qenë kontribut i ish-bashkëjetuesit tim dhe një pjesë tjetër ka qenë dhuratë që më bënë prindërit për blerjen e apartamentit me rastin e futjes në apartamentin e ri në nëntor 2005.”*

24.6.2 Në përgjigje të pyetësorit të datës 4.12.2019, subjekti ka sqaruar se nuk janë deklaruar në deklaratën “Vetting” si burim, të ardhurat e z. Gj., dhe as të familjes së saj, për faktin se ajo deri në dhjetor të vitit 2005, ka jetuar së bashku me prindërit dhe kontributi i tyre në blerjen e apartamentit ka qenë fakti që ajo nuk ka kryer shpenzime jetike, pasi çdo e ardhur e pagës së saj, kursehej për llogari të saj. Për sa i përket kontributit të bashkëshortit që ka deklaruar në procesverbalin e datës 2.10.2014 të ILDKPKI-së, në atë kohë ka pasur parasysh që nga dhjetori i vitit 2005 ka filluar të bashkëjetojë me z. Gj., dhe ai ka kontribuar në kryerjen e shpenzimeve jetike apo në formën e dhuratave simbolike që ka bërë në atë periudhë. Ky deklarim është bërë në vitin 2014 dhe i është referuar kontributit të tij për kohën që kanë filluar bashkëjetesën.

24.6.3 Nga verifikimi i DVP-ve vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, deklarimeve të subjektit të bëra në ILDKPKI dhe në përgjigje të pyetësorëve të KPK-së në lidhje me shumën 15, 000 euro

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019 drejtuar Zyrës Qëndrore të Pasurive të Paluajtshme; Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019, drejtuar UKT-së; Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019, drejtuar OSHEE-së; Shkresë nr. *** prot., datë 1.11.2019, drejtuar OSHEE-së; Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019, drejtuar bankave; Shkresë nr. *** prot., datë 1.11.2019, drejtuar bankave.

ka rezultuar se: (i) ka mospërputhje të deklarimeve të subjektit në DVP/2005 me deklarinimet e saj pranë ILDKPKI-së në vitin 2014; (ii) Subjekti rivlerësimin në deklaratën “Vetting” dhe deklarinimet gjatë procesit të vetingut nuk është konsistent me deklarinimet e mëparshme (v. 2005 dhe v. 2014) lidhur me burimin e apartamentit;

24.6.4 Subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me këtë rezultat të hetimit.

24.6.5 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi se:

(i) *“Në DVP/2005 është bërë deklarimi jo vetëm i veprimeve, por edhe ai i burimit të burimit, duke u përshkruar këto burime dhe shkaqet e krijimit të tyre;*

(ii) *pranë ILDKPI-së kam deklaruar se shuma 15, 000 euro përbëhet nga shuma 800,000 lekë depozituar në Bankën “Tirana” më 19.9.2003, e cila në fakt në fund të vitit 2004 u bë 1,254,484 lekë, shumë të cilën e kam tërhequr nga banka si dhe kursimet e mia të vitit 2005;*

(iii) *nuk ka asnjë mospërputhje mes deklarimeve, pasi e njëjta shumë e kursyer në thelb nga paga ka pësuar transformime të ndryshme, dhe unë kam mundur të përshkruaj gjithçka, edhe burimin e burimit. Por, në analizë të fundit, paga ime dhe huaja e marrë prej vëllait përbëjnë shkaqet fillestare të krijimit të kësaj pasurie, pasi, qoftë në formë depozite, qoftë në formë cash, zanafilla e krijimit mbeten paga ime. Pra, në deklaratat e pasurisë së vitit 2005 është bërë një përshkrim në mënyrë më analitike, ndërsa në deklaratën “Vetting”, edhe pas njohjes më të mirë të procesit të legjislacionit të deklarinimit të pasurive, përshkrimi është bërë në mënyrë më sintetike, por jo me përmbajtje të ndryshme apo me papërputhshmëri përmbajtësore, pasur parasysh situatën disi të ndërlikuar në të cilën jetoja me familjen e origjinës dhe konceptin e ri të bashkëjetesës dhe legjislacionit për deklarimin e pasurisë.*

(iv) *Nëse mbledhim shumën 15, 000 euro me shumën 23,000 USD dhe huan në shumën 2, 000, 000 lekë, është e barabartë me shumën totale të shpenzuar për blerjen e apartamentit, dhe nëse do të shtonim edhe shumën 800, 000 lekë, atëherë nuk do kishte kuptim që unë të merrja hua shumën 2, 000, 000 lekë. Ju vë në dukje se shpjegimet e mia lidhur sa më sipër janë në përputhje me transaksionet bankare transparente dhe të gjurmueshme.”*

24.6.6 Mbështetur në deklarinimet e subjektit si dhe në provat e administruara rezulton se, subjekti në kohë të ndryshme ka deklaruar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie në mënyrë të ndryshme, por që këto deklarime nuk cenojnë thelbin e burimit të pasurisë së saj, i cili është të ardhurat nga paga e subjektit. Mospërputhja midis deklarimeve të subjektit nuk ka ardhur si pasojë e qëllimit të saj për të fshehur apo deklaruar në mënyrë të pasaktë këtë pasuri, por siç rezulton, ajo është përpjekur për të detajuar burimin e kësaj pasurie. Nga analiza financiare konstatohet se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie, për rrjedhojë nuk ngrihen dyshime si dhe nuk provohet se subjekti ka patur për qëllim të deklarojë në mënyrë të pasaktë burimin e kësaj pasurie. Në Aneksin D të Kushtetutës si dhe në ligjin nr. 84/2016 nuk parashikohen si shkak për shkarkim mospërputhjet në deklarime të subjektit në deklaratat periodike, të cilat nuk kanë patur për qëllim fshehje ose paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurisë.

Pas verifikimit nga Komisioni, ka rezultuar se subjekti ka deklaruar saktë këtë pasuri si dhe burimin e ligjshëm të saj në deklaratën “Vetting”.

24.7 Bazuar në deklarinimet e subjektit të rivlerësimin gjatë hetimit administrativ dhe provave të administruara konstatohet se shuma 15, 000 euro dhe shuma 800, 000 lekë, të deklaruara në DVP/2005, rrjedhin nga njëra - tjetra.

24.7.1 Në DVP/2003 subjekti ka deklaruar se ka një depozitë në “Tirana Bank” me gjendje 800, 000 lekë, të krijuar më datë 19.9.2003. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar këtë depozitë. Më tej, kjo depozitë ka patur ecurinë si më poshtë:

Banka Tirana	Shuma e tërhequr	Shuma e Depozituar/lekë	Përshkrimi i veprimit
19.9.2003		800,000	Depozituar <i>cash</i> , investohet në Dep.Afat
20.2.2004		200,000	Depozituar <i>cash</i> , investohet në Dep.Afat
5.5.2004		200,000	Depozituar <i>cash</i> , investohet në Dep.Afat
23.11.2004	200,000		Maturohet Dep.Afat – tërhiqet <i>cash</i>
1.12.2004	654,484		Maturohet Dep.Afat – tërhiqet <i>cash</i>
23.12.2004	400,000		Maturohet Dep.Afat – tërhiqet <i>cash</i>
Totali i tërhequr në fund të vitit 2004			1,254,484 Lekë
13.9.2005		1,700,000	Depozituar <i>cash</i> , investohet në Dep.Afat
5.10.2005	1,712,552		Maturohet Dep.Afat – tërhiqet <i>cash</i>

24.7.2 Nga lëvizjet bankare konstatohet se, në fund të vitit 2004 (nga data 23.11.2004-23.12.2004), subjekti ka tërhequr në total shumën 1, 254, 484 lekë⁸. Nga verifikimi i DVP/2004 nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar si shtesë pasurie shumën 454,484 lekë (pasi shuma 800, 000 lekë është deklaruar në DVP/2003). Nga analiza financiare për vitin 2004 konstatohet se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për të depozituar shumën 400,000 lekë, e cila nuk rezulton e deklaruar si shtesë të ardhurash në DVP/2004. Në përfundim të hetimit ka rezultuar se subjekti nuk ka deklaruar saktësisht gjendjen *cash* në vitin 2004 në shumën 454,484 lekë.

24.7.3 Në lidhje me këtë rezultat të hetimit, subjektit iu kërkuan shpjegime bindëse.

24.7.4 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjekti shpjegoi se: “*Shtesa e të ardhurave të mia në DVP/2004, prej 454,484 lekë (1,254,484 lekë – në fund të vitit 2004, me 800.000 lekë në fund të vitit 2003), nuk është deklaruar, duke menduar se burimi i kësaj llogarie, e cila ishte paga ime, ishte deklaruar në rubrikën tjetër të DVP-së.*”

24.7.5 Duke analizuar përgjigjen e subjektit, në raport me veprimet bankare të kryera, rezulton se këto shpjegime janë në përputhje me transaksionet bankare, për pasojë ato janë lehtësisht të gjurmueshme dhe të verifikueshme. Subjekti ka deklaruar rregullisht të ardhurat nga paga e saj, të gjitha veprimet i ka kryer nëpërmjet bankës, ka kryer tërheqjen e shumës për pagesën e çmimit të apartamentit, analiza financiare e kryer rezulton pozitive.

⁸ Subjekti ka sqaruar se këtë shumë e ka tërhequr për të kryer pagesë kësti të apartamentit. (shih pyetësor nr.2)

Komisioni, krijon bindjen e mbështetur në prova se mosdeklarimi i shtesës së të ardhurave në shumën 454,484 lekë në DVP/2004 nuk përbën mungesë të burimeve financiare për blerjen e apartamentit.

Komisioni, në arritjen e këtij konkluzioni, mbështetet në faktin se nga ana e subjektit të rivlerësimit llogaria bankare⁹ në të cilën është tërhequr shuma 454, 484 lekë, është deklaruar në DVP/2003, gjithashtu edhe si burim për blerjen e apartamentit në DVP/2005. Subjekti ka kryer tërheqjen e kësaj shume në fund të vitit 2004 dhe e ka rikthyer sërish në bankë në datë 13.09.2005, duke shtuar dhe kursimet e vitit 2005.

24.8 Në DVP/2004 subjekti deklaron një depozitë në vlerën 23,000 USD, krijuar në vitin 2004.

24.8.1 Në lidhje me burimin e kësaj depozitë ajo deklaron: *“Lekë të kthyera në dollarë të kursyera nga puna ime janë 4.000 USD.”* Në seksionin informacion konfidencial, subjekti në lidhje me këtë depozitë sqaron se: *“Në emrin tim është një depozitë në bank pa afat, të cilat janë të familjes time të origjinës, depozitë mbi të cilën veproj në emër dhe për llogari të prindërve të mi dhe dy vëllezërve të mi në emigracion.”*

24.8.2 Në përgjigje të pyetësorit nr.1¹⁰, subjekti ka deklaruar si burim të kësaj depozite të ardhurat e pagës së saj ndër vite, duke filluar që nga viti 1993.

24.8.3 Deklarimi i subjektit gjatë hetimit administrativ nuk përputhet me deklarimin e saj në DVP 2004 në lidhje me pronësinë e kësaj depozite pasi, ndryshe sa ka deklaruar në vitin 2004, ajo tashmë deklaron se të ardhurat për krijimin e kësaj depozite janë të sajat dhe jo të familjarëve të saj. Për këtë arsye, iu kërkuan sqarime¹¹ të mëtëjshme subjektit në lidhje me këtë konstatim.

24.8.4 Subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3 ka sqaruar se: *“Deklarimi im në DVP/2004 se 4.000 USD është kontributi im, ndërsa pjesa tjetër i përket familjes së origjinës, është një pakujdesi nga ana ime, pasi kam dashur të shpreh të kundërtën dhe situata reale është e kundërta. Pra 4.000 (katër mijë) USD nga të ardhurat e prindërve, dhe pjesa tjetër pagat e mia.*

Në lidhje me konstatimin tuaj, sipas deklaratës sime të DVP/2004, kam deklaruar se “shuma 4.000 USD është kontributi im, ndërsa pjesa tjetër i përket familjes së origjinës”, kjo shprehje e imja ka të bëjë me faktin se në familjen e origjinës, unë nuk kontribuoj me të ardhurat e mia nga paga, dhe çdo e ardhur e pagës kursehej në llogarinë time, të cilën më pas e kam shpenzuar për krijimin/pagimin e shumën 23.000 USD për blerjen e apartamentit. Kjo depozitë, shuma 23.000 USD, është krijuar nga të ardhurat nga puna ime ndër vite qysh në vitin 1993 kur fillova punë...

Shpjegoj se, nga momenti i fillimit të detyrës maj 1993 deri në dhjetor 2005 unë bashkëjetoja me prindërit pasi isha beqare. Për këtë periudhë, ne si familje, kemi patur ekonomi të përbashkët deri në dhjetor 2005, prandaj unë depozitën 23,000 USD e kam deklaruar si kursime nga të ardhurat familjare në DVP/2004 e konstatuar nga ana juaj.”

24.8.5 Duke qenë se përgjigjet e subjektit gjatë hetimit administrativ nuk përputhen me deklaratimet e kryera në DVP 2004/2005, subjekti iu kërkuan shpjegime bindëse me dërgimin e rezultateve të hetimit në lidhje me këtë mospërputhje.

⁹ Subjekti në DVP/2003 deklaroi depozitë bankare “Tirana Bank” 800, 000 lekë.

¹⁰ Shiko pyetësorin nr. 1, datë 31.10.2019.

¹¹ Shiko pyetësorin nr. 2, datë 4.12.2019.

24.8.6 Në parashtrimet e paraqitura para Komisionit, subjekti i qëndron shpjegimit të mëparshëm, duke shtuar se: “Në vijim të gjithë deklaratimeve periodike vjetore si edhe në deklaratën “Vetting”, ku kam deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit, këtë llogari e kam deklaruar me burim nga paga ime. Në këtë mënyrë shpjegohet deklarimi im lapsus në DVP/2004 dhe qëndrueshmëria në deklaratimet vijuese për këtë gjetje, ku kam keqkuptuar kontributin familjar me kontributin tim në kursimet e krijuara si pajë timen në gjirin e familjes së origjinës.”

24.8.7 Pavarësisht shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se është fakt që ka mospërputhje në deklaratim të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit dhe deklaratimeve të saj në vitin 2005 në lidhje me burimin e shumës 23, 000 USD. Për të provuar vërtetësinë në deklaratimin e subjektit, në lidhje me mundësitë për krijimin e depozitës prej 23, 000 USD në vitin 2004, Komisioni ka hetuar dhe analizuar faktet dhe provat, si dhe ka kryer analizë financiare. Në analizë janë përfshirë të ardhurat nga pensionet e prindërve, qiraja e përfituar nga babai i subjektit, dhurata nga vëllai i subjektit¹² dhënë prindërve të tij, e cila është përfituar nga shitja e makinës.

24.8.8 Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti rezulton se bazuar në aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. *** akti, datë 30.07.1993, babai i subjektit ka përfituar 10, 500 m² sipërfaqe bujqësore “ullishte”. Të ardhurat¹³ e z. H. M., nga përdorimi i tokave bujqësore për periudhën 1994-2014 (përkatesisht tokës “ullishte”, me sipërfaqe 7500 m² dhe asaj me sipërfaqe 2000 m² të përfituar sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi) janë në shumën 11,557,519 lekë.

	para 2001	2003	Totali (deri fund 2003)
PASURI	0	-132 926	3 953 993
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>		-132 926	3 953 993
Likuiditete gjendje		3 953 993	
TË ARDHURA dokumentuar	6 486 426	1 417 368	10 375 901
Të ardhura nga paga e subjektit	2 099 051	619 868	3 670 345
Të ardhura nga paga e pensioni i babait	419 065	124 728	734 021
Të ardhura nga paga e pensioni i nënës	348 179	83 064	577 547
Të ardhura nga qiraja	615 275		615 275
Nga dhurata e I. M.	570 000		570 000
Interesa nga Bankat		54 552	82 295
Nga kultivimi i Ullinjve	2 434 856	535 156	4 126 418
SHPENZIME	1 114 935	239 273	1 824 665
Mundësia për kursime	5 371 492	1 311 021	4 597 244
<i>Mundësia për kursim kumulative</i>	5 371 492	4 597 244	

¹² Z. I. M., me kontratë nr.*** rep, datë 24.1.1998 ka shitur automjetin tip “kamion” për shumën 570, 000 lekë. Referuar deklaratës noteriale nr. ***, datë 17.12.2019 të z. I. M., shuma e përfituar prej tij nga shitja e kamionit i është dhënë familjes së tij të origjinës, prindërve të tij, për ta përdorur për nevojat e tyre familjare.

¹³ Shih raport vlerësimi të datës 10.12.2019 të ekspertes L. B.

24.8.9 Pasi u njoh me rezultatet e hetimit, subjekti ka depozituar pranë Komisionit edhe dokumentacion shtesë¹⁴ në lidhje me të ardhurat e siguruar nga babai i saj, z. H. M., nga shfrytëzimi i ullishteve.

24.8.10 Lidhur me të ardhurat e babait të subjektit¹⁵, të përfituara nga vetëpunësimi në bujqësi, rezulton se referuar legjislacionit në fuqi, duke filluar nga viti 1994 e deri më sot, ka si objekt taksimi vetëm sipërfaqjen e tokës që zotëron dhe jo të ardhurat që gjeneron toka bujqësore. Fermerët nuk deklarojnë në ardhura lidhur me produktet e tyre. Pas vitit 2012 në legjislacion u përfshi skema e rimbursimit të TVSH-së për fermerin nëpërmjet të cilës, fermerët që kërkonin rimbursim të TVSH-së, duhet të deklaronin shitjet e tyre. Gjithashtu, duhet konsideruar edhe fakti se familjet bujqësore shpenzimet e jetesës i kanë më të vogla se familjet e tjera që llogariten nga INSTAT-i, pasi koston e ushqimit e prodhojnë vetë. Komisioni në llogaritjen e të ardhurave nga ulliri të babait të subjektit është mbështetur në dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit si dhe në të dhënat e INSTAT-it¹⁶.

24.8.11 Në përfundim të shqyrtimit të provave dhe kryerjes së analizës financiare, rezulton se subjekti së bashku me familjen e saj të origjinës kanë patur mundësi për të krijuar depozitën në shumën 23, 000 USD, si në rast se kontributi i subjektit konsiderohet 4, 000 USD, ashtu dhe në rastin kur kontributi i subjektit do të konsiderohet 19, 000 USD.

Mbështetur në këtë analizë mospërputhjet e konstatuar në deklarinimin e subjektit gjatë hetimit do të konsiderohen si pasaktësi, por këto pasaktësi nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkim, për sa kohë nga analiza financiare provohet mundësia e subjektit dhe familjes së saj të origjinës për krijimin e depozitës në shumën 23, 000 USD.

Analiza e kryer nga Komisioni, në lidhje me huan e marrë nga të tretë në shumën 2, 000, 000 lekë

24.9. Si burim tjetër për blerjen e apartamentit, subjekti ka deklaruar huan e marrë nga vëllai i saj, z. I. M. Komisioni hetoi gjerësisht në lidhje aftësitë huadhënëse të z. M.

24.9.1 Në deklaratat periodike subjekti e ka deklaruar huan si më poshtë:

- Në DVP/2005 subjekti deklaroi se vlera e huas është 20, 000 euro;
- Në DVP/2006 deklaroi se huaja është 2,000,000 lekë;
- Në DVP/2010 deklaroi se ka shlyer shumën 1,000,000 lekë, si burim deklarohet shuma e siguruar nga shitja e aksioneve deklarim, i cili përputhet me deklaratën “Vetting”;
- Në DVP/2016 deklaroi se ka shlyer shumën 1,000,000 lekë, si burim deklarohet të ardhurat nga shitja e automjetit “ML” në shumën 900,000 lekë, me kontratë nr.***, datë 19.12.2016 dhe të ardhurat familjare vjetore deklarim, i cili përputhet me deklaratën “Vetting”.

24.9.2 Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë hua deklaroi:

*“Shlyerje tërësisht e detyrimit që rrjedh nga kontrata e huasë marrë vëllait I. M., në shumën 1,000,000 lekë, përdorur për blerjen e apartamentit në vitin 2005 (shuma totale e huasë 2.000.000 lekë, pa afat kthimi, pa interes). **Burimi i krijimit të shlyerjes së huas: Gjatë vitit***

¹⁴ Deklaratë e lëshuar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit “****” sh.p.k., T. Sh., në lidhje me dorëzimin e ullinjve në fabrikë nga z.H. M., dhe z.I. M.; Fletëhyrje lëshuar nga “****” sh.p.k në lidhje me dorëzimin e ullinjve në fabrikë nga z.H. M., dhe z.I.M.; Deklaratë e lëshuar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit “****” sh.p.k., E. M., në lidhje me dorëzimin e ullinjve në fabrikë nga z.H. M.;

Mandat pagesë e subjektit “****” sh.p.k; Deklarata lëshuar nga z. M. Rr.

¹⁵ Shih vendim nr. 191, datë 26.7.2019, vendim nr. 234, datë 04.2.2020 të KPK-së.

¹⁶ Shiko analizën financiare.

2010 është shlyer shuma prej 1.000.000 lekë, e cila është siguruar nga shitja e 10 % të aksioneve të shoqërisë “****” sh.a., të personit të lidhur. Ndërsa detyrimi i mbetur 1.000.000 lekë, është shlyer gjatë vitit 2016, nga të ardhurat e siguruara nga shitja e automjetit “Benz ML 270”, në shumën 900.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2016, si dhe nga të ardhurat familjare vjetore.

24.9.3 Komisioni konstatoi se në DVP/2005 kjo hua është deklaruar në monedhën euro, ndërsa në vijim, përfshirë edhe deklaratën “Vetting”, është deklaruar në lekë. Për këtë konstatim është pyetur subjekti.

24.9.4 Në përgjigjen e pyetësorit të parë, subjekti ka pranuar se deklarimi i huasë në euro ka qenë një lapsus i bërë në DVP/2005, meqënëse transaksioni për blerjen e apartamentit u krye në euro.

24.9.5 Komisioni e konsideron bindës shpjegimin e subjektit për një lapsus, sepse siç konstatohet nga deklaratimet e mëpasshme, përfshirë edhe deklaratën “Vetting”, subjekti këtë hua e ka deklaruar në lekë, duke deklaruar dhe shlyerjen e saj në lekë.

24.9.6 Në lidhje me aftësitë financiare të huadhënësit, në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar: “Burimi i origjinës së vlerës monetare të huadhënësit janë të ardhura familjare të siguruara nga marrëdhënia e punës, paga si punëmarrës në shtetin grek, pasi nga viti 1992 e aktualisht është rezident në shtetin grek, provuar nga leja e qëndrimit afatgjatë deri në datë 1.4.2020.”

24.9.7 Komisioni i ka kërkuar subjektit dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat e vëllait të saj. Në përgjigje të pyetësorit të parë ajo ka vendosur në dispozicion dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat e vëllait të saj, më konkretisht “Raportet e likuidimit të tatimit mbi të ardhurat personale të personave fizik mbi bazë deklarate fillestare të z. I. M.” për periudhën 2001-2017. Bazuar në këtë dokumentacion, rezulton se vëllai i subjektit për periudhën 2001-2005 ka krijuar të ardhura në shumën 37,053 euro. Gjithashtu, subjekti në përgjigje të pyetësorit të dytë, ka sqaruar më tej se përveç të ardhurave nga punësimi në shtetin grek, vëllai i saj ka përfutur tokë bujqësore “ullishte” në pronësi nga ligji nr.7501 datë 19.7.1991 “Për tokën” dhe ka siguruar të ardhura nga shfrytëzimi i saj. Këto të ardhura janë përfshirë në analizë financiare.

I. M.	1994-2000	2001	2002	2003	2004	2005	Total
Paga e I. M.		3 480	3 741	3 477	5 525	1 486	17 710
Paga e bashkëshortes			2 991	2 924	6 625	6 803	19 343
Nga ullishtja	13 540	3 509	3 604	3 203	3 921	3 494	31 271
Të ardhura Total	13 540	6 989	10 337	9 605	16 071	11 782	68 324
Shpenzimet e jetesës ¹⁷		5 894	6 656	7 112	7 950	8 899	
Mundësia për kursim	13 540	1 096	3 681	2 493	8 121	2 883	31 814
Kumulative	13 540	14 636	18 317	20 810	28 931	31 814	

24.9.8 Pas përfundimit të hetimit, pasi u njoh me rezultatet e tij, subjekti ka depozituar dokumentacion për të provuar të ardhurat e vëllait të saj nga shfrytëzimi i ullinjve për

¹⁷ Sipas të dhënave të ELSTAT <http://www.statistics.gr/el/statistics/-/publication/SFA10/>

Ilogaritjen e të cilave Komisioni ka përdorur të njëjtën metodikë si për të ardhurat e babait të subjektit.

24.9.9 Komisioni, pasi vlerësoi dokumentacionin e administruar, si edhe kreu analizën financiare, konkludon se z. I. M., ka patur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas.

24.10 Në përfundim të hetimit, pasi u vlerësuan faktet dhe provat e administruara, Komisioni kreu dhe analizën financiare të subjektit në momentin e blerjes së shtëpisë, sipas së cilës rezultoi se ajo ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

	6.10.2005
PASURI	2 297 267
Apartament, 71 m ² , rr. “***”, Tiranë	5 622 748
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	-3 325 481
Likuiditete gjendje	661 145
DETYRIME	2 000 000
Marrë hua nga vëllai I. M.	2 000 000
PASURI NETO	297 267
Të ARDHURA dokumentuar	1 393 036
Të ardhura nga paga e subjektit	685 860
Të ardhura nga paga e pensionit të babait	102 404
Të ardhura nga paga e pensionit të nënës	74 311
Interesa nga bankat	39 901
Nga ullishtja	490 560
SHPENZIME	228 185
Shpenzime jetese	228 185
Mundësia për kursime	867 584

25. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshortin e saj ka shitur apartament banimi, me sipërfaqe 55 m², më 6.5.2005 me kontratë nr. ***, për shumën 1,600,000 lekë.

25.1 Ky apartament është blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në datën 26.11.2004 me kontratë nr. *** për shumën 3,150,000 lekë.

25.2 Nga analiza financiare¹⁸ rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti.

	<i>1995 deri 26.11.2004</i>
PASURI	7 170 940

¹⁸ Në analizën financiare për bashkëshortin e subjektit, është përdorur metodologjia kumulative, pasi ai nuk është subjekt deklarimi në këtë periudhë. Në shpenzimet e jetesës janë përfshirë vetëm ato të z. Gj., sipas standardit të ILDKPKI-së për 1 person.

Apartment, 55 m ² , Fier	3 150 000
Tokë truall, 150 m ² , lagjja “****”, Fier	115 800
Apartament, 73,25 m ² , lagjja “****”, Fier	26 978
Apartament, 66 m ² , rr. “****” Tiranë	1 400 000
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	<i>2 478 162</i>
TË ARDHURA dokumentuar	10 636 550
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	1 086 495
Të ardhura nga qiratë	6 720 000
Interesa nga bankat	230 055
Të ardhura nga shitja e pasurive	2 600 000
Shpenzime	920 277
Shpenzime jetese	768 959
Paguar taksë në Hipotekë	141 120
Shpenzime ose pagesa të tjera	10 198
Mundësia për kursime	2 545 333

Në përfundim të hetimit, Komisioni konstaton se nuk ka dyshime për këtë pasuri.

26. Nga ZVRPP-ja Fier informohemi se subjekti i rivlerësimit ka në bashkëpronësi pasurinë me nr. ***, zona kadastrale ***, me sipërfaqe 62.65 m², e cila ndodhet në Patos. Kjo pasuri është përfituar me kontratë privatizimi banese datë 25.5.1993 firmosur nga z. H. M. Në përbërjen familjare të z. H. M., në datë 1.12.1992 ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit.

26.1 Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton që të ketë deklaruar në deklaratën “Vetting” pronësinë mbi 1/4 pjesë takuese të apartamentit me sipërfaqe 62.65 m², në qytetin e Patosit, të përfituar nga privatizimi. Në lidhje me këtë rezultat subjektit iu kalua barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

26.2 Në parashtrimet e paraqitura përpara Komisionit subjekti ka pranuar këtë mangësi në plotësimin e deklaratës “Vetting”. Ajo e ka konsideruar si parregullsi, e cila ka ardhur për shkak të një harrese njerëzore, vendndodhjes së largët, mënyrës së fitimit të pronësisë përmes privatizimit në kohë të hershme, mospërdorimit të saj faktik për një periudhë tejet të gjatë, mosvënies në diskutim të provueshmërisë së ligjshmërisë së burimit për krijimin e kësaj pasurie, mungesës së dashjes për të mos ta deklaruar, mungesës së posedimit faktik të kësaj pasurie, vlerës së papërfillshme të saj në raport me pasuritë e saj si subjekt rivlerësimi, ngarkesës në punë, angazhimeve familjare si nënë dhe si bashkëshorte, shkaqeve shëndetësore, urgjencës për të mbledhur dokumentacionin e nevojshëm për procesin e rivlerësimit. Subjekti ka arsyetuar kështu se mungon qëllimi për të mosdeklaruar apo për ta fshehur këtë pasuri lehtësisht të gjetshme dhe të gjurmueshme.

26.3 Komisioni vlerëson se nga të gjitha rrethanat e faktit del se kemi të bëjmë me një harresë të paqëllimshme, që nuk ka sjellë fshehje të pasurisë, për aq kohë sa evidentohet në regjistrat hipotekore si dhe origjina e kësaj pasurie është nga privatizimi. Duke qenë se ky apartament është në pronësi të përbashkët midis subjektit dhe familjes të saj të origjinës, nuk evidentohen të dhëna që të lindin dyshime për fshehje apo veprime korruptive në blerje të kësaj pasurie. Pavarësisht kësaj, Komisioni vlerëson se mbetet fakt që subjekti nuk e ka deklaruar këtë

bashkëpronësi në deklaratën “Vetting”, duke e vënë subjektin në kushtet e pasaktësisë në deklaram, por që nuk ka patur për qëllim fshehjen e pasurisë, duke mos përbërë në këtë mënyrë shkak për shkarkimin e subjektit.

27. Depozitë¹⁹ në “ProCredit Bank”, në favor të fëmijës së mitur, çelur në vitin 2007

(i) Shuma 650.033 lekë (ii) Pjesa takuese 100% (iii) Burimi i deklaruar i pasurisë: të ardhurat nga pagat gjatë viteve.

🚩 Hetimi²⁰ i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri

27.1 Bazuar në shkresën e “Procredit Bank” rezulton se gjendjet e llogarive të S. Gj., në këtë bankë kanë qenë përkatësisht 592,016.71 lekë, në datën 21.01.2017, në llogarinë nr. *** dhe 62,820.96 lekë, në datën 01.01.2017, në llogarinë nr. ***.

Në datë 13.02.2017 është hapur depozitë me afat 5-vjeçar në “Procredit Bank” në emër të S.Gj., në shumën **658,400 lekë**.

Në përfundim përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

28. Gjendje Cash 700,000 lekë

28.1 Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kursimeve *cash*.

29. “Mastercard Prepaid”, “Intesa SanPaolo Bank”, çelur më datë 06.01.2017

Nuk rezultojnë dyshime apo paqartësi.

Subjekti ka deklaruar në emër të bashkëshortit, z. S. Gj., këto pasuri:

30. Apartament²¹, me sipërfaqe 66 m², adresa: rr. “****”, Tiranë.

(ii) çmimi i blerjes 1.400.000 lekë (i) Blerë në vitin 2001, me kontratën e shitblerjes nr. *** kol., nr. *** rep., datë 19.12.2001 (iii) Zotërimi 100 %.

30.1 Burimi i deklaruar i pasurisë: (i) Të ardhura nga paga, të kursyera gjatë viteve **(ii)** të ardhura të krijuara nga qiraja e objektit lokal - bar – bilardo, Fier.

🚩 Hetimi²² i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri

30.2 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me kontratë shitjeje nr. *** kol., datë 19.12.2001, ka blerë apartament me sipërfaqe 66 m², me çmim 1, 400, 000 lekë.

30.3 Ky apartament është blerë nga bashkëshorti i subjektit gjatë regjimit martesor të mëparshëm (përpara bashkëjetesës/martësës me subjektin) dhe është i regjistruar në ZVRPP me nr. pasurie ****, zona kadastrale ****.

30.4 Nga analiza financiare më poshtë konstatohet se bashkëshorti ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
--	------	------	------	------	------	------	------

¹⁹ Subjekti ka depozituar nxjerrje llogarie nga “ProCredit Bank”, datë 13.10.2016, për S. Gj.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019 drejtuar bankave.

²¹ Subjekti ka depozituar: (i) Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2001, si dhe (ii) Vërtetim Hipotekor nr. *** datë 27.12.2001.

²² Shkresë nr. *** prot., datë 22.02.2019, drejtuar Zyrës Qëndrore të Pasurive të Paluajtshme; Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019 drejtuar UKT-së; Shkresë nr.*** prot., datë 22.2.2019, drejtuar OSHEE-së.

PASURI	0	0	0	0	115 800	0	1 426 978
Tokë truall, 150 m ² , lagjja “***”, Fier					115 800		
Apartament, 73,25 m ² , lagjja “***”, Fier							26 978
Apartament, 66 m ² , rr. “***” Tiranë							1 400 000
TË ARDHURA dokumentuar	1 006 407	1 054 975	1 055 107	1 055 625	1 060 166	1 075 642	1 015 077
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	46 407	94 975	95 107	95 625	100 166	115 642	55 077
Të ardhura nga qiratë	960 000	960 000	960 000	960 000	960 000	960 000	960 000
Shpenzime	32 485	66 483	60 000	60 000	63 097	108 000	176 820
Shpenzime jetese	32 485	66 483	60 000	60 000	60 000	108 000	108 000
Paguar taksë në Hipotekë							66 120
Shpenzime ose pagesa të tjera					3 097		2 700
Mundësia për kursime	973 922	988 493	995 107	995 625	881 269	967 642	-588 721
Mundësia për kursim kumulative	973 922	1 962 415	2 957 522	3 953 147	4 834 416	5 802 058	5213 337

Në përfundim nuk rezultojnë dyshime në lidhje me këtë pasuri të bashkëshortit të subjektit.

31. Dy garazhe²³ me sipërfaqe 14 m² secili, adresa: rr. “***”, Tiranë.

(i) Blerë sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.11.2013, nga “Raiffeisen Bank” (ii) çmimi i blerjes 1, 300, 000 lekë (iii) Pjesa 100%.

31.1 Burimi i deklaruar i pasurisë: (i) Shuma prej 1, 000, 000 lekë janë të ardhura të realizuara nga shitja e 10 % të aksioneve të shoqërisë “***” sh.a. (shumë të cilën e kemi patur *cash* në shtëpi) (ii) shuma prej 300, 000 lekë kursime nga paga.

🚧 Hetimi²⁴ i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri

31.2 Në datë 26.11.2013 me kontratën nr. *** bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë dy garazhe, me sipërfaqe 14 m² secili, me numër pasurie ***, zona kadastrale *** dhe nr. ***, zona kadastrale ***, për çmimin 1,300,000 lekë. Pagesa e këtyre garazheve është kryer nëpërmjet sistemit bankar në bankën “Raiffeisen” si më poshtë:

- Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në datë 25.11.2013 ka depozituar shumën 1,300,000 lekë në llogarinë e tij bankare në “Raiffeisen Bank”;

²³ Subjekti ka depozituar: (i) Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., dt. 26.11.2013; (ii) Certifikatë për Vërtetim Pronësie, nr. ***, datë 18.12.2013; (iii) Certifikatë për Vërtetim Pronësie nr. ***, datë 18.12.2013; (iv) Konfirmë depozitimi nga S. Gj., në “Raiffeisen Bank”, datë 25.11.2013, shuma 1.300.000 lekë.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019, drejtuar Zyrës Qëndrore të Pasurive të Paluajtshme; Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019, drejtuar bankave.

- Kjo shumë bazuar në nxjerrjen e llogarisë më lart është transferuar në “Raiffeisen Bank” në po të njëjtën datë.

📌 Hetimi/Analiza ligjore-financiare për burimin e krijimit të pasurisë së llojit garazh

31.3 Në DVP/2010 bashkëshorti i subjektit deklaroi tërheqjen²⁵ nga depozita të shumës 2, 000, 000 lekë, e cila ka si burim të ardhurat e siguruar nga shitja e aksioneve shoqërisë “****” sh.a.

31.3.1 Në këtë DVP, në lidhje me përdorimin e kësaj shume, deklarohet se 1,000,000 lekë u përdorën për shlyerjen pjesërisht të huas së z. I. M., dhe shuma 1,000,000 lekë është dhënë hua.

31.3.2 Në lidhje me këtë hua, subjekti, gjatë hetimit, ka sqaruar se shumën 1,000,000 bashkëshorti i saj ia ka dhënë hua vajzës së tij, shtetases A.Gj., e cila kërkonte që të aplikonte për studime jashtë vendit. Kjo shumë është dhënë rreth muajit korrik-gusht 2010 dhe është kthyer në janar të vitit 2011. Subjekti ka pretenduar se meqënëse ka qenë marrëdhënie ndërmjet babait dhe bijës e bërë pa shkresë, bashkëshorti i saj ka qenë i bindur se ka qenë brenda vitit dhe nuk e ka deklaruar këtë shumë në vitin 2010 si kursim *cash*.

31.3.3 Në kushtet kur bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar kthimin e huas nga e bija, Komisioni nuk e ka përfshirë këtë shumë në analizën financiare. Për pasojë, mundësia për blerjen e kësaj pasurie pasqyrohet si më poshtë:

	25.11.2013
PASURI	1 262 773
2 garazhe ndodhur në rr. “****” Tiranë, (100% bashkëshorti pjesë takuese)	1 300 000
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	-37 227
Likuiditete gjendje	1 450 682
TË ARDHURA dokumentuar	1 195 358
Të ardhura nga paga e subjektit	988 732
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	198 264
Interesa nga Bankat	8 362
SHPENZIME	512 126
Shpenzime jetese	381 344
Shpenzime udhëtimi TIMS	110 781
Paguar qira (sipas pyetësorit 2)	20 000
Mundësia për kursime	-579 540

31.3.4 Në përfundim të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime mbi arsyet e mosdeklarimit të kthimit të kësaj huaje.

31.3.5 Subjekti e ka konsideruar mosdeklarimin e kthimit të huas si një parregullsi formale. Ajo ka depozituar pranë Komisionit kontratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.03.2009 e shitjes së aksioneve të shoqërisë “****” sh.a., për të provuar arkëtimin e shumës prej 2, 000, 000 lekë, si dhe deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.12.2019 nga A. Gj., vajza e bashkëshortit. Subjekti shpjegon me tej se z. Gj., kishte idenë se, për sa kohë e

²⁵ Ky deklarimi konfirmohet nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortit të subjektit në “Societe Generale Albania Bank” nga ku rezulton se në datë 12.5.2010 ai ka tërhequr shumën 2,000,000 lekë.

kishte deklaruar të tërhequr nga banka dhe dhënë hua, fakti i kthimit të huas nuk ndikonte në deklarim, pasi ato ishin gjendje *cash*, për më tepër që kjo shumë ishte dhënë hua vajzës, hua e paformalizuar për shkak të marrëdhënieve të posaçme.

31.3.6 Komisioni, pasi shqyrtoi shpjegimet dhe prova e subjektit, konstaton se në DVP/2010 subjekti ka deklaruar dhënien e huas në shumën 1, 000, 000 lekë. Kthimi i kësaj huaje nuk rezulton i deklaruar në asnjë nga DVP-të pasardhëse. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e garazheve shumën 1, 000, 000 lekë që ka për burim shitjen e aksioneve të shoqërisë “***”sh.a. nga bashkëshorti i saj.

Nga hetimi nuk rezulton që subjekti apo bashkëshorti i saj të kenë deklaruar/kryer blerje apo shpenzime në shumën 1, 000, 000 lekë. Nga verifikimi i llogarive bankare nuk rezulton që bashkëshorti i subjektit dhe subjekti të kenë kryer depozitime në një shumë të tillë me përjashtim të datës 25.11.2013 ku është depozituar shuma 1, 300, 000 lekë, e cila ka shërbyer për blerjen e garazheve.

Në përfundim të fakteve të mësipërme, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka qenë i saktë në deklarimin e gjendjes *cash* ndër vite, pasi ajo nuk ka deklaruar shumën 1, 000, 000 lekë (e cila ka burim të ligjshëm), por ndërkohë në deklaratën “Vetting” ajo ka deklaruar saktësisht se shuma 1, 000, 000 lekë ka shërbyer si burim për blerjen e garazheve, fakt që provohet dhe me depozitim të shumës 1, 300, 000 lekë në “Raiffeisen Bank”. Mosdeklarimi i kthimit të shumës 1, 000, 000 lekë është një pasaktësi e subjektit në deklaratat periodike, por jo në deklaratën “Vetting”, për rrjedhojë, Komisioni pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti si dhe mbështetur në analizën e mësipërme, do të përfshijë këtë shumë në analizën financiare të vitit 2013, duke e kthyer gjendjen e subjektit për këtë vit, pozitive.

32. Automjet “Mercedez- Benz”²⁶ modeli “B 180”, vit prodhimi 2010, CDI, data e blerjes 20.6.2014, çmimi i blerjes 6.557 euro.

32.1 Burimi i deklaruar i pasurisë:(i) të ardhura nga paga si dhe **(ii)** huaja prej 5.000 euro marrë nga i paralinduri i bashkëshortes (babai), e cila është shlyer totalisht gjatë vitit 2015, nga të ardhurat familjare vjetore.

🚦 Hetimi²⁷ i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri

32.2 Bazuar në faturën nr. ***, datë 20.6.2014, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë automjetin “Mercedes” Class B 180 CDI, ***, me çmimin 6.557 euro. Detyrimet doganore, bazuar në deklaratën doganore, janë 187,757 lekë.

32.3 Komisioni kreu analizën financiare në lidhje me këtë shpenzim, prej së cilës rezulton:

	20.6.2014
PASURI	815 994
Automjet “Daimler Chrysler”, ***	918 753
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	-102 759
Likuiditete gjendje	1 479 994
DETYRIME	700 550

²⁶ Subjekti ka depozituar: (i) Faturë nr. ***, datë 20.6.2014, me palë shitëse shoqëria “***”s.a.s dhe palë blerëse S. Gj., për blerje automjeti “Mercedes Class B 180”, CDI. Vlera 6.557 euro; (ii) Kontratë shitblerje nr. ***, datë 19.12.2016.

²⁷ Shkresë, nr. *** prot., datë 22.2.2019 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Hua nga H. M.	700 550
PASURI NETO	115 444
TË ARDHURA dokumentuar	775 914
Të ardhura nga paga e subjektit	656 191
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	108 144
Interesa nga bankat	11 579
SHPENZIME	484 096
Shpenzime jetese	307 394
Shpenzime udhëtimi TIMS	176 701
Mundësia për kursime	176 374

Nga analiza financiare rezulton se bashkëshorti i subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

Hetimi/Analiza ligjore-financiare për burimin e krijimit të pasurisë së llojit automjet

32.4 Si burim për blerjen e automjetit, subjekti ka deklaruar dhe hua në shumën 5, 000 euro marrë babait të saj, z. H. M.

32.4.1 Për të provuar të ardhurat e ligjshme të babait të saj, subjekti ka paraqitur provat e mëposhtme:

- i) Kontratë huadhënieje, nr. ***²⁸, datë 13.11.2014, objekti i së cilës është dhënia hua e shumës 5, 000 euro nga z. H. M., tek subjekti. Në këtë kontratë përcaktohet se shuma 5, 000 euro i është dhënë subjektit në datë 13.6.2014;
- ii) Kontratë shitblerjeje, nr. *** datë 17.4.2008, objekt i të cilës është shitja e një trualli me sipërfaqe 1507 m², me numër pasurie ***, zona kadastrale ***, ndodhur në ***, Fier, kundrejt shumës prej 1, 478, 367 lekë;
- iii) Kontratë shitblerjeje, nr. *** datë 20.1.2009, objekt i të cilës është shitja e një trualli me sip. 540 m², me numër pasurie ***, zona kadastrale ***, ndodhur në ***, Fier, kundrejt shumës 529,740 lekë;
- iv) Kontratë shitblerjeje, nr. ***, datë 23.3.2006, objekt i të cilës është shitja e një trualli me sipërfaqe 682 m², me numër pasurie ***, zona kadastrale ***, ndodhur në ***, Fier, kundrejt shumës prej 150, 000 lekë;
- ii) Kontratë qiraje nr. ***, datë 20.7.1994 lidhur midis qiradhënës H. M., dhe qiramarrës Komuna ***. Objekti i kontratës dhënia me qira e një godine të ndodhur të fshatin ***, me sipërfaqe 120 m² dhe truall përreth 60 m², e cila shërbente për ambiente pune e zyra të Komunës ***, për periudhën 1.1.1994 - 30.9.1994. Qiraja mujore 10,000 lekë.
- iii) Kontratë qiraje nr. ***, datë 7.8.1995 lidhur midis qiradhënës H. M., dhe qiramarrës Komuna ***. Objekti i kontratës dhënia me qira e një godine të ndodhur të fshatin ***, të përbërë nga gjashtë dhoma dhe një truall funksional, të ndodhur rreth zyrave, e cila shërbente për ambiente pune e zyra të Komunës ***, për periudhën 1.10.1994 - 30.6.1996. Qiraja mujore 10, 000 lekë.
- iv) Kontratë qiraje nr. ***, datë 23.12.1996 lidhur midis qiradhënës H. M., dhe qiramarrës Komuna ***. Objekti i kontratës është përsëritja e kontratës së datës 7.8.1995, për periudhën 1.7.1996 -31.12.1998. Qiraja mujore 10, 000 lekë.
- v) Vërtetim datë 06.11.2019 i ALSSH-së Fier nëpërmjet së cilës vërtetohet se z. H. M., përfiton pension pleqërie në masën 23, 272 lekë.

²⁸ E cila është administruar dhe me shkresë datë 12.11.2019 të noterit publik I. Sh.

32.4.2 Siç rezulton nga dokumentacioni i depozituar por dhe nga analiza financiare më poshtë, babai i saj ka patur aftësi huadhënëse në shumën 5, 000 euro.

Huadhënësi H. M.	2006 deri në 13.06.2014
Shitje trualli, sipërfaqe 682 m ² , Fier, 23.4.2006	150 000
Shitje trualli, sipërfaqe 1507 m ² , Fier, 17.4.2008	1 478 367
Shitje trualli, sipërfaqe 540 m ² , Fier, 20.1.2009	529 740
Interesa nga bankat	679 207
Të ardhura nga ullishtja	5 841 438
Likuiditete të mbartura nga 2005 H.M.	410 006
Të Ardhura	9 088 752
Shpenzimet e jetesës	0
Shpenzime	0
<i>Ndryshimi i likuiditeteve</i>	<i>7 642 513</i>
Pasuri	7 642 513
<i>Mundesia për kursim, kumulative</i>	<i>1 146 245</i>

32.4.3 Kjo hua rezulton e shlyer në vitin 2015 bazuar në deklaratimet e subjektit në DVP/2015. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen e kësaj huaje.

33. Nga hetimi ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 19.12.2016 ka shitur automjetin tip “Mercedez Benz”, ***, për shumën 900,000 lekë.

33.1 Ky automjet është blerë në datë 24.9.2007 për shumën 15, 300 euro, bazuar në deklaratën doganore “Import 4”, detyrimi doganor 614, 157 lekë.

33.2 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së z. S. Gj., në “Societe Generale Albania”, rezulton se në datën 06.09.2007, ai ka bërë një tërheqje *cash* të shumës 12,000 Euro.

33.3 Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti.

Në përfundim përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

34. Depozitë²⁹ në “Tirana Bank”. Vlera 8, 436 USD dhe depozitë në “Tirana Bank”, vlera 1,363 euro.

34.1 Burimi i deklaruar i pasurisë: (i) Të ardhura familjare gjatë viteve.

 **Hetimi³⁰ i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri**

²⁹ Subjekti ka depozituar: (i) Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, datë 11.10.2016, për depozitë në emër të S. Gj., në vlerën 1.363 Euro; (ii) Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, dt.11.10.2016, për depozitë në emër të S. Gj., në vlerën 8.436 USD.

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019 drejtuar bankave.

34.2 Bazuar në shkresën e “Tirana Bank” rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka patur llogari në euro me gjendje 1.363,5 në fund të vitit 2016 dhe në USD me gjendje 8.436,03 në fund të vitit 2016.

Në përfundim përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

34.3 Nga nxjerrja e llogarisë në euro të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në “Tirana Bank” rezulton se në datë 12.3.2002 subjekti i rivlerësimit ka depozituar shumën 10,000 euro.

34.4 Lidhur me këtë konstatim, subjekti ka sqaruar se: *“Nga nxjerrja e llogarisë “Tirana Bank”, në llogarinë rrjedhëse të z. Gj., numër llogarie ***, në monedhën euro për periudhën 1.1.2002 deri në 31.12.2002, rezulton se ka patur të depozituar shumën 54,786.62 euro (është bërë një shkëmbim i USD në euro 0.867).*

Në datën 5.3.2002, z. Gj., ka tërhequr shumën 10,000 euro nga llogaria rrjedhëse më sipër, dhe ka mbetur gjendje 44,786.62 euro.

*Në datën 12.3.2002, z. Gj., ka hapur depozitë me afat me numrin e llogarisë ***, në monedhën euro, në të njëjtën bankë dhe pranë të njëjtës degë. Po në datën e hapjes (datë 12.3.2002) është depozitur cash shuma 10,000 Euro, me përshkrimin “Dep. për hapjen e një depozite me afat, nga Irena Maneku”, shumë e cila ka kaluar në depozitë më afat në emër të tij. Dua të shpjegoj se: llogaria nr. ***, është depozitë me afat dhe titullar i saj është vetëm z. Gj., i cili është zotëruesi i llogarisë më sipër, depozitë me afat. Unë nuk kam pasur asnjë lidhje me këtë veprim bankar si dhe nuk kam pasur në pronësinë time asnjë pjesë të shumës së deklaruar më lart.”*

34.5 Nga verifikimi i levizjeve të llogarive të bashkëshortit të subjektit konfirmohet deklarimi i subjektit se burimi i shumës 10, 000 euro janë të ardhurat e bashkëshortit të saj, pasi ai në datë 5.3.2002 ka tërhequr shumën 10, 000 euro, e cila rezulton e depozituar në datë 12.3.2002 për të çelur një depozitë bankare në emër të z. S. Gj.

34.6 Në prapësimet e veta subjekti ka sqaruar më tej në lidhje me këto transaksione: *“... Burimi i depozitës së kësaj shumë rrjedh nga llogaria rrjedhëse që z. Gj., ka pasur në të njëjtën bankë në monedhën euro, nr. *** llogarie, në shumë 54.786 euro që kanë si burim të ardhura të përfituara nga shitja e pasurisë lokal si dhe qiradhënia e lokalit. Në datë 5.3.2002 nga kjo llogari rrjedhëse ka tërhequr shumën prej 10,000 euro dhe më datën 12.3.2002 (6 ditë më pas) këtë shumë e ka depozituar personalisht në llogarinë depozitë me afat të hapur prej meje në të njëjtën bankë dhe pranë të njëjtës degë”.*

34.7 Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka depozituar edhe shkresën e Tirana Bank nr. *** prot., datë 10.12.2019, drejtuar z. Gj., në të cilën informon se: *“Klientja, zj. Irena Maneku nuk rezulton të jetë si person i përbashkët në llogarinë tuaj, por depozita me afat e vendosur në llogarinë tuaj dhe veprimet e mëtejshme, janë kryer nga ju personalisht bazuar edhe në specimenin tuaj tek certifikata e depozitës me afat...”*

Në përfundim Komisioni vlerëson se nuk ka paqartësi apo dyshime në lidhje me këtë pasuri. Kjo depozitë e ka origjinën e saj gjatë kohës së regjimit të parë martesor të zotit Gj.

35. Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit³¹

🚩 **Hetimi³² i kryer nga Komisioni**

35.1 Në lidhje me të ardhurat nga qiraja

35.1.1 Në deklaratën “Vetting” subjekti deklaroi se bashkëshorti i saj ka përfituar të ardhura nga qiradhënia e objektit 2-katësh, me sipërfaqe ndërtimore 150 m², lokal – bar - bilardo dhe truallit 150 m², ndodhur në lagjen “****”, Fier. Qiraja mujore 80,000 lekë.

35.1.2 Subjekti i rivlerësimit për të provuar deklarinimin e saj ka depozituar kontratë qiraje të datës 13.2.1996 ku z. S. Gj., jep me qira një lokal me dy kate “bar-lojëra”, të ndodhur në lagjen “****” Fier. Periudha e dhënies me qira 1.01.1995 - 31.12.2001. Vlera e qirasë 80,000 lekë/muaj.

35.1.3 Komisioni i ka kërkuar informacion DRT-së Fier në lidhje me kontratën e qirasë. Nga ana e saj jemi informuar se: *“Në dokumentacionin e arkivuar në DRT Fier nuk u gjendën të dhëna për reregjistrimin në vitet pasardhëse dhe as të dhëna mbi të ardhurat, fitimet, humbjet e realizuara nga aktiviteti apo qiratë për vitet 1997-2001.”*

35.1.4 Nga ana e subjektit, në përgjigje të pyetësorit të datës 4.12.2019 është depozituar dokumentacion provues për pagimin e detyrimeve tatimore më konkretisht urdhërpagesë për tatimin e mbajtur në burim në shumën 884,190 lekë dhe veprim në llogari i “Credins Bank”, datë 13.12.2019, nëpërmjet të cilit vërtetohet pagimi i shumës 884, 190 lekë.

Subjekti gjithashtu ka depozituar deklaratë noteriale nr. ***, datë 17.12.2019 të z. I. M., i cili ka deklaruar se e njeh detyrimin për pagimin e tatimit për vlerën e qirasë të paderdhur në buxhetin e shtetit që duhet të paguhej në lidhje me kontratën e qirasë, në shumën 864, 000 lekë, të paguar nga z. S. Gj., dhe se do t’i rimbursojë z. Gj., këtë shumë në llogarinë e tij personale ose t’ia dorëzojë *cash* sapo të ketë mundësi financiare.

35.1.5 Komisioni konstaton se të ardhurat nga qiraja të bashkëshortit të subjektit janë krijuar para se subjekti të kishte filluar bashkëjetesën/martesën me z. Gj., gjatë regjimit të parë martesor të tij. Gjithashtu, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues të kohës kontratën e qirasë për këto të ardhura, sipas të cilit ambienti i është dhënë me qira një personi të tatueshëm, të regjistruar në organet tatimore, për rrjedhojë detyrimin për pagimin e tatimit në burim e ka patur personi i tatueshëm, referuar legjislacionit tatimor në fuqi. Në këto kushte, Komisioni konstaton se, megjithëse detyrimi tatimor i përkiste qiramarrësit, në momentin e konstatimit të faktit të mospagimit të tyre, subjekti dhe bashkëshorti i saj e kanë shlyer këtë detyrim.

Në vlerësim të fakteve më sipër, lidhur me periudhën kur janë krijuar të ardhurat nga marrëdhënia e qirasë dhe përcaktimi kontraktual lidhur me pagesën e detyrimit për pagimin e tatimit, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi ligjore. Po ashtu, fakti se ajo dhe bashkëshorti në momentin e konstatimit të kësaj problematike,

³¹ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: 1. Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.1.2002; 2. Kontratë qiradhënie; 3. Vërtetim, nr. *** prot., datë 18.11.2016, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier; 4. Vendim nr. *** të Gjykatës së Rrethit Fier, të datës 26.6.1995; 5. Vendim, nr. *** , të Gjykatës së Rrethit Fier, të datës 29.9.1998; 6. Kontratë shitjeje aksionesh nr. *** , datë 21.3.2009; 7. Deklaratë për shitje aksionesh nr. *** , datë 30.8.2006; 8. Mandat nga “Tirana Bank”, dt.30.8.2006; 9. Vendim, nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 16.3.2007; 10. Shkresë, nr. *** prot, datë 24.11.2016 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë; 11. Kontratë shitblerjeje nr. *** , datë 10.09.2003.

³² Shkresë, nr. *** prot., datë 22.2.2019, drejtuar QKB-së; Shkresë, nr. *** prot., datë 22.2.2019 drejtuar bankave; Shkresë, nr. *** prot., datë 22.2.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; Shkresë, nr. *** , datë 1.11.2019, drejtuar DRT-së Fier; Shkresë, nr. *** prot., datë 1.11.2019, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier.

kanë përmushur detyrimin tatimor ndaj shtetit, duke paguar edhe kamatëvonesat, Komisioni vlerëson se këto të ardhura duhet të konsiderohen të ligjshme³³.

35.2. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e objektit 2-katësh, me sipërfaqe 150 m², lokal- bar- bilardo dhe truallit prej 150 m² në shumën 2,000,000 lekë.

35.2.1 Bazuar në dokumentacionin e administruar rezulton se:

- Me vendimin nr. ***, datë 26.6.1995, të Gjykatës së Rrethit Fier, është vërtetuar fakti juridik i pronësisë së z. S. Gj., mbi një lokal - bufe-lojëra, të ndodhur në lagjen “****”.
- Me vendimin nr.***, datë 29.09.1998, të Gjykatës së Rrethit Fier, z. S. Gj., ka fituar të drejtën e pronësisë mbi një sipërfaqe tokë truall prej 150 m², ndodhur në lagjen “****”, Fier. Bazuar në këtë vendim, vlerë e ndërtimit të lokalit bar-bufe është 4, 206, 250 lekë.
- Në datën 8.1.2002 me kontratë shitblerjeje nr. ***, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka shitur dy pasuritë e mësipërme për shumën 2,000,000 lekë. Për shitjen e kësaj banese ka dhënë pëlqimin dhe ish-bashkëshortja e z. S. Gj., F. Gj.

Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara.

35.3 Të ardhura të krijuara nga shitja e 10% të aksioneve të shoqërisë “**” sh.a. në shumën 2,000,000 lekë.**

35.3.1 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit sipas kontratës së shitblerjes së aksioneve nr. ***, datë 21.3.2009 ka shitur 10% të aksioneve të shoqërisë “****” sh.a. për shumën 2,000,000 lekë.

35.3.2 Këto aksione, bazuar në deklaratën nr. ***, datë 30.08.2006, të shoqërisë “****” sh.a. rezultojnë se janë blerë në datë 30.08.2006, për shumën 3,300,000 lekë.

35.3.3 Si burim për blerjen e këtyre aksioneve subjekti në deklaratën “Vetting” ka deklaruar një tërheqje në shumën 30.000 USD³⁴ në “Tirana Bank”, duke bashkëlidhur dhe mandatarkëtimin, nga i cili provohet kjo tërheqje. Nga analiza financiare rezulton se bashkëshorti i subjektit i kishte mundësitë për krijimin e kësaj shume.

35.3.4 Në lidhje me këto aksione, nga hetimi administrativ i KPK-së, rezulton se QKB-ja konfirmon faktin se z. S. Gj., ka qenë aksioner i shoqërisë “****” sh.a. (***) me NIPT *** dhe është larguar nga kjo shoqëri me kontratë shitjeje nr. ***, datë 7.3.2009. Nga shkresa e DRT-së Tiranë nr. *** rezulton se kjo shoqëri nuk ka shpërndarë dividend.

Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara.

35.3 Të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit në lagjen “**”, Fier**

35.3.1 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit së bashku me znj. F. Gj., me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 10.9.2003 kanë shitur apartament, me sipërfaqe 73.25 m² për shumën 1,200,000 lekë. Kjo pasuri është privatizuar në datë 15.12.1993 nga z. S. Gj., duke paguar shumën 26,978 lekë.

Këto të ardhura do të konsiderohen në shumën 600, 000 lekë, duke qenë se bashkëshorti i subjektit ka patur në pronësi ½ e kësaj pasurie. Subjekti, bazuar në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 2.10.2014 ka deklaruar se bashkëshorti ka përfutuar shumën 600, 000 lekë nga shitja e kësaj pasurie.

36. Të ardhura të përfituara nga vendimi i gjykatës nr. * datë 01.06.2007 në shumën 347,495 lekë**

³³ Shiko vendimin nr. ***, datë 12.2.2019, vendimin nr. **, datë 1.8.2018, vendimin nr. ***, datë 22.12.2019, vendimin nr.***, datë 24.7.2019 të KPK-së.

³⁴ Ky fakt konfirmohet dhe nga nxjerrja e llogarisë të bashkëshortit të subjektit në “Tirana Bank”.

Bazuar në nxjerrjen e llogarisë të “Raiffeisen Bank” të z. S. Gj., rezulton se në datë 5.9.2007 është depozituar 347,495 lekë me emërtim “V. GJYKATE N. *** D.1.6.07 PROKURORIA”. Ndërsa në datën 2.11.2007 me të njëjtin emërtim është depozituar shuma 40,700 lekë.

Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara.

37. Në lidhje me likuiditetet

Hetimi³⁵ i kryer nga Komisioni

37.1 Nga nxjerrja e llogarisë në euro në bankën “Societe Generale Albania” të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit rezulton se në datë 9.7.2007 ka një derdhje në shumën 12, 000 euro nga G. B., shumë e cila tërhiqet *cash* nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në të njëjtën datë.

37.2 Në lidhje me këtë konsatim subjekti sqaron se:

“Është i vërtetë konstatimi juaj se z. G. B., ka depozituar shumën 12,000 euro në llogarinë e bashkëshortit tim në SGS (ish-Banka Popullore), më datë 9.7.2007, por dua të shpjegoj se: Kjo shumë i përkiste bashkëshortit tim S. Gj.

G. B., ka qenë punonjës i Bankës “SGS” nga data 15.7.2005 deri më datë 15.12.2009, punonjës i regjimit të brendshëm, dega Fier; dhe për shkak të miqësisë dhe marrëdhënies së besimit me njëri-tjetrit, ia ka besuar që këtë shumë ta depozitonte ai në llogarinë e tij. ”

37.3 Subjekti, për të vërtetuar deklarimin e saj, ka depozituar dokumentat e mëposhtme:

- Deklaratë noteriale, nr. ***, datë 6.11.2019, të z. G. B., i cili deklaron se:

“...Kam qenë punonjës në ish-Bankën Societe Generale Albania... është e vërtetë se në vitin 2007 kam kryer një veprim bankar për depozitim parash në vlerën 12, 000 euro në llogarinë e z. S. Gj. Deklaroj se në kushtet që unë kam patur miqësi me S., duke patur besim të plotë te njëri-tjetri, unë thjesht kam bërë derdhjen e kësaj shume në llogarinë e tij, por paratë kanë qenë të S...”

- Vërtetim datë 6.11.2019 i “OTP Bank”, nëpërmjet të cilit vërtetohet se z. G. B., ka punuar nga data 15.7.2005 - 15.12.2009 pranë kësaj banke.

- Statement banke

37.4 Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti provohet se z. G. B., ka qenë punonjës i Bankës “Societe Generale Albania” dhe depozitimi i kryer prej tij në shumën 12, 000 euro është bërë për llogari të z. S. Gj. Duke marrë në konsideratë këtë fakt shuma 12, 000 euro do të përfshihet në analizë financiare si likuiditet i z. S. Gj.

37.5 Analizë Financiare

	3.7.2007
PASURI	677 318
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	<i>677 318</i>

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019 drejtuar bankave.

Likuiditete gjendje	2 040 222
TË ARDHURA dokumentuar	662 765
Të ardhura nga paga e subjektit	434 634
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	215 459
Interesa nga Bankat	12 672
SHPENZIME	1 659 334
Shpenzime jetese	206 614
Shpenzime udhëtimi TIMS	0
Shpenzime ose pagesa të tjera (shp.hipoteke)	1 800
Depozituar 12,000 euro në Societe Generale Albania	1 450 920
Mundësia për kursime	-1 673 887

37.6 Nga analiza financiare duket se bashkëshorti i subjektit nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar depozitën në shumën 12, 000 euro. Në lidhje me këtë rezultat hetimi, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit.

37.7 Subjekti pas kalimit të barrës së provës sqaroi se: *“Shuma 12, 000 euro ka burim të ligjshëm, ato janë nga të ardhurat të krijuara e kursyera ndër vite, nga qiraja dhe shitja e pasurive të paluajtshme e të luajtshme të z. S. Gj. Nga lëvizjet e llogarisë të z. Gj, në “Tirana Bank” konstatohet se ai në datë 6.10.2005 këmben shumën prej 18, 000 USD në euro dhe e tërheq. Kjo shumë nuk rezulton të jetë deklaruar si burim për blerjen e ndonjë pasurie, por dhe as si kursim cash. Shpjegoj se këtë shumë z.Gj., jo vetëm nuk e ka deklaruar, por edhe as nuk e ka investuar në blerjen e ndonjë pasurie, por e ka mbajtur cash (lënë në ruajtje shtetasit G.B.), i cili e ka ridedepozituar në vitin 2007, në llogarinë e z.Gj., pranë Societe Generale Albania”.*

37.8 Lidhur me analizën financiare dhe mundësinë e krijimit të të ardhurave për shumën 12.000 euro, konstatohet se në DVP/2007, në faqen 8, personi i lidhur S. Gj., ka deklaruar:

- i. Pakësim pasurie - shitje e autoveturës “Benz” 190, blerë 6, 000 USD dhe shitur 4, 000 USD;
- ii. Shtim pasurie, blerje automejeti, tip “Benz 270”, në shumën 15, 000 euro, blerja e të cilës është bërë nga: lekët e marra nga shitja e automjetit “Benz 190”, si dhe lekët e depozituara në bankë të tërhequra nga llogaria USD 2006, (viti lapsus) si dhe kursime të vitit 2007.

37.9 Në lidhje me mospërfshirjen në këtë analizë financiare të shumës prej 4.000 USD të përfituara nga shitja e automjetit “Benz 190”, dhe që ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit “Benz”, ***, nga ana e bashkëshortit të subjektit, rezulton se kjo shumë është deklaruar në DVP/2007, faqe nr. 8.

37.9.1 Subjekti i është drejtuar me kërkesë DRSHTRR-së Tiranë, e cila me shkresën nr. ***, datë 24.12.2019, njofton se nuk disponon dosjen e mjetit me targa ***, pasi mjeti ka kaluar në DRSHTRR-në Dibër, më pas është hequr përfundimisht nga qarkullimi, dhe rezulton në sistemin me status “çregjistrim i përhershëm”. Dosja ndodhet në Arkivën Kombëtare Durrës. Lidhur sa më sipër, DRSHTRR-ja Tiranë i është drejtuar Arkivës Durrës për të dërguar dosjen, në mënyrë që të sigurohet dokumentacioni përkatës.

37.9.2 Subjekti ka shpjeguar se ka bërë përpjekje maksimale, i është ridrejtuar DRSHTRR-së, e cila pas informacionit në drejtoritë rajonale përkatëse, ka kthyer përgjigjen në datë 10.2.2020 se: *“Pas kërkesës për transferimin e dosjes së mjetit, me targë ***, sipas shkresës sonë me nr.*** prot., datë 26.12.2019, jemi njoftuar nga DPSHTRR me shkresën *** prot, datë 6.2.2020 se nga verifikimi i bërë në DRSHTRR-në Dibër, dhe në Arkivën Qendrore, rezulton se dosja e këtij mjete nuk gjendet.”* Nga rrethanat më sipër, ndodhem në kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacionin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurisë, sipas nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, pasi:

- i) kam shteruar të gjitha mjetet ligjore të kërimit;
- ii) jam në pamundësi për ta marrë në rrugë të tjera;
- iii) ka kaluar afati 10 - vjeçar i ruajtjes së dokumentacionit dhe nuk kam pasur detyrim ligjor për ta ruajtur kontratën.

37.10 Komisioni pasi analizoi shpjegimet e subjektit si dhe provat e paraqitura³⁶ prej saj konstaton se (i) bashkëshorti i saj pasi ka këmbyer shumën 18, 000 USD në euro e ka tërhequr në datë 6.10.2005; (ii) në këtë moment, subjekti nuk ka qenë ende në kushtet e bashkëjetesës/martësës ligjore me zotin Gj.; (iii) në DVP/2007, në momentin e blerjes së makinës, subjekti ka deklaruar si burim tërheqjen nga llogaria në USD në vitin 2006 si dhe nga shitja e makinës “Benz” në shumën 4, 000 USD.

37.11 Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e makinës “Benz” në shumën 4, 000 USD Komisioni vlerëson se (i) subjekti ka kryer të gjitha përpjekjet për të siguruar dokumentacion provues, por siç rezulton nga përgjigjja e DRSHTRR-së Tiranë, dosja e mjetit nuk gjendet, në këto kushte subjekti është në kushtet e pamundësisë; (ii) automjeti tip “Benz” është deklaruar në DVP/2005 i blerë në shumën 6, 000 USD dhe në DVP/2007 deklarohet shitja e tij në shumën 4, 000 USD; (iii) deklaramet periodike, në kuptim të nenit 32/5 të ligjit 84/2016, mund të përdoren si provë nga Komisioni. Në këto kushte shuma 4, 000 USD do të përfshihet në analizë financiare.

37.12 Në përfundim, Komisioni konkludon se shpjegimet e subjektit, të mbështetura në prova, krijojnë bindjen se subjekti ka patur mundësi financiare për këtë veprim.

38. Në lidhje me huat e dhëna nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit

Hetimi³⁷ i kryer nga Komisioni

38.1 Nga hetimi rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në vitin 2008 dhe 2012 ka dhënë hua, të cilat janë kthyer brenda vitit, përkatësisht:

38.1.1 Në datë 24.4.2012 me kontratë huaje nr.*** bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i ka dhënë hua z. A. Z., shumën 34.500 USD.

Në këtë kontratë përcaktohet se huaja jepet për një afat tre muaj 24.4.2012 - 24.7.2012 me qëllim “blerje automate kompjuterike”.

38.1.1.1 Në lidhje me këtë hua subjekti ka depozituar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të bashkëshortit të saj, të cilat kanë patur si burim huan e marrë nga z.

³⁶ Subjekti ka bashkëlidhur: (i) Shkresë, kthim përgjigjeje DRSHTRR-ja Tiranë, nr.*** prot., datë 24.12.2019; (ii) Shkresë, kthim përgjigjeje DRSHTRR-ja Tiranë, nr.*** prot., datë 10.2.2020.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 1.11.2019, drejtuar noterit publik B. H. Shkresë, nr. *** prot., datë 1.11.2019, drejtuar noterit publik E. H.

K. M³⁸. Nga hetimi rezultoi se z. M., kishte të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje pasi:

- i. Të ardhurat nga paga e z. M., deri në 12.4.2012 janë 1,505,688 lekë (rreth 14,000 USD);
- ii. Me kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme, nr. ***, datë 15.03.2002, z. M., me bashkëshorten e tij kanë shitur një apartament me sipërfaqe 48.3 m² në Fier, në shumën 1,900,000 lekë;
- iii. Me kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme, nr. ***, datë 14.04.2003, bashkëshortja e z. M., ka shitur një apartament me sipërfaqe 53,66 m² në Fier, në shumën 1,000,000 (një milion) lekë;
- iv. Me testamentin nr. ***, datë 8.10.2008 i të ndjerit z. R. R., me anë të cilit ai ka disponuar që të gjitha të ardhurat në llogarinë e tij kursimi/rrjedhëse pranë “Bankës Amerikane” ia ka lënë znj. B. M., bashkëshortes së z. K. M. Bazuar në *statement* të “Intensa Sanpaolo Bank”, në monedhën USD, në emër të R. R., rezulton se në datë 23.4.2012, znj. B. M., ka tërhequr shumën 14, 553.00 USD;
- v. Bazuar në nxjerrjen e llogarisë të shoqërisë “****” sh.p.k., në “Raiffeisen Bank” dhe “Intesa San Paolo Bank”, ku rezulton se:
 - Në “Raiffeisen Bank”, në datë 10.4.2012 është tërhequr shuma 3,800,100 lekë nga z. M.;
 - Në bankën “Intesa San Paolo” në datën 10.4.2012 është tërhequr *cash* nga z. M., shuma 250,000 lekë.
- vi. Shuma e tërhequr *cash* nga z. M., nga llogaritë e shoqërisë “****” sh.p.k., pak ditë para dhënies së huas, është 4, 050, 100 lekë ose 38,000 USD³⁹, shumë kjo që e mbulon plotësisht shumën e dhënë hua.

Për sa më sipër konstatohet se z. M., ka patur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas z. Gj.

38.1.2 Në datë 26.11.2008 me kontratë huaje nr. ***, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i ka dhënë hua z. A. Z., shumën 16, 000 USD. Kthimi i kësaj huaje është bërë brenda vitit kalendarik. Ky fakt provohet me mandatpagesën e datës 7.12.2008 në të cilin shkruhet “*kthim huaje kontrata nr. *** datë 26.11.2008*” e firmosur nga z. S. Gj., dhe z. A. Z. Në lidhje me këtë hua subjekti ka depozituar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të bashkëshortit të saj, të cilat kanë patur si burim huan e marrë nga z. H. M⁴⁰. Nga hetimi rezultoi se z. M., kishte të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje.

Në konkluzion të hetimit për këto hua, rezulton se huadhënësit kanë patur mjete monetare të mjaftueshme për huan.

38.1.3. Nga analiza financiare ndër vite, e kryer për subjektin e rivlerësimit, si dhe bashkëshortin e saj, nga lidhja e tyre me martesë ligjore rezulton se subjekti nuk justifikon mbulimin e shpenzimeve me të ardhura në vitin 2014 në shumën 146, 111 lekë. Komisioni

³⁸ Shih Deklarata noteriale, nr. *** datë 13.11.2019 e z.K. M., dhe z. S. Gj., ku deklarohet se:

“... Unë kisha mundësi financiare (të ardhura nga biznesi im) për të investuar në këtë aktivitet i propozova z. Gj., që të krijonim një ortakëri në fushën e lojërave të fatit... Në vitin 2012 në funksion të hapjes së aktivitetit i kam dhënë z. Gj., shumën 34.500 USD...Kjo shumë më është kthyer nga z. Gj., brenda rreth dy muajve pasi negociatat për blerjen e pajisjeve dhe hapjen e biznesit dështuan...”

³⁹ Kursi këmbimit USD:LEK data 31.12.2012, Banka e Shqipërisë.

⁴⁰ Shih Deklaratë noteriale nr. *** datë 13.11.2019 e z.H. M., dhe z. S. Gj., ku deklarohet:

“...Në vitin 2008 i kam dhënë hua bashkëshortit të vajzës time shumën 1, 500, 000 lekë. Kjo shumë është kthyer brenda vitit...Për shkak të marrëdhënieve familjare të posaçme që kemi, nuk kemi bërë kontratë huaje formale...Unë i nënshkruari S. J. Gj., deklaroj se i kam marrë hua z. H. M., në vitin 2008 shumën 1, 500, 000 lekë shumë të cilën ia kam huazuar z. A. Z...”

vlerëson që kjo shumë në mungesë të të ardhurave, nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore për subjektin.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

38.2 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën “Vetting”, pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

38.3 Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ajo ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

38.4 Siç u evidentua edhe më sipër, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor në rezultatet financiare të viteve respektive.

38.5 Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaratim dhe balanca negative e fondeve në vitin 2014 prej 146, 111 lekë, nuk është e mjaftueshme që të pasjellë aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

38.6 Për më tepër, Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se, në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

38.7 Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër, nuk duhet të ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, ato nuk cenojnë figurën e gjyqtarit, dhe as besimin e publikut te drejtësia.

38.8 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

39. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka patur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit 84/2016.

39.1 Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavaruar të Kualifikimit raportin⁴¹ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, ku ka konstatuar se, (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës si dhe; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

39.2 Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

39.3 Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjensitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

40. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

41. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

41.1 Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

41.2 Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

41.3 Saktësia e formularit të vetëdeklarimit: Formulari paraqitet i plotë dhe i nënshkruar në çdo faqe, sipas parashikimit të udhëzimit të shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁴¹ Raporti me nr. *** prot., datë 2.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZh-së, nr. ***, datë 11.9.2019)

41.4 Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së: **(i)** Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezultojnë se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Irena Gjoka janë paraqitur 3 ankesa (1 në vitin 2013 dhe 2 ankesa në vitin 2014) në Inspektoratin e KLD-së. Nga këto, 1 ankesë e vitit 2014 është arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, ndërsa 2 ankesa (1 ankesë e vitit 2013 dhe 1 ankesë e vitit 2014) janë verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mosrespektim formal të ligjit, ku është sugjeruar “tërheqje vëmendjeje me shkrim” gjyqtares. **(ii)** Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Irena Gjoka përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

41.5 Nga ana e Komisionit⁴² i është kërkuar informacion KLGJ-së dhe Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me subjektin e rivlerësimit. **(i)** Bazuar në shkresën e Ministrisë së Drejtësisë për subjektin e rivlerësimit rezultojnë dy ankesa, të cilat janë shqyrtuar nga ana e Ministrisë, duke u konstatuar prej saj se ato i përkasin vendimarrjes së gjykatës dhe për rrjedhojë, shqyrtimi i tyre nuk është në kompetencën e Ministrisë. **(ii)** Bazuar në shkresën e KLGJ-së rezultojnë se për subjektin janë paraqitur 9 ankesa, nga këto ankesa, vetëm në një të një prej tyre, që i përket ankuesit “****” sh.a/D. Ç., janë konstatuar problematika.

41.6 Komisioni administroi vendimin gjyqësor nr. ***, datë 20.10.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë, nëpërmjet të cilit është vendosur prishja e vendimit nr. ***, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe kthimi i çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues.

Në këtë vendim, Gjykata e Apelit Vlorë ka arsyetuar se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Fier është marrë në shkelje të normave procedurale dhe në zbatim të gabuar të ligjit material, pasi ka konstatuar se: *(i) Vendimi i ndërmjetëm për zhvillimin e gjyqimit në mungesë të anës së paditur, ndërkohë që ai ka vënë në dijeni gjykatën qysh në seancë, është marrë në kundërshtim me kërkesat e nenit 179 të K.Pr.Civile. (ii) Gjykata ka shkelur parimin e parashikuar nga nenet 18 dhe 20 të K.Pr.Civile. (iii) Gjykata ka mbajtur dy standarde në këtë gjykim, pasi për të njëjtën shkak me kërkesë të paditësve ka shtyrë seancën e datës 2.7.2008. (iv) Gjykata nuk ka përsëritur më njoftimet për seancat e ardhshme, duke bërë që pala e paditur të mos marrë pjesë në seancat e datave 15.7; 9.9; dhe 18.9.2008 në të cilat është marrë në shqyrtim akti i ekspertimit, duke i hequr mundësinë për të shtruar pyetje për ekspertin apo të bëjë kontestime apo prapësimet e nevojshme. (v) Në kundërshtim me kërkesat e nenit 185 të K.Pr.Civile është rrëzuar kërkesa e paditësve për ndryshimin e shkakut ligjor të padisë dhe nuk është marrë parasysh kërkesa e paditësve për vlerësimin e dëmit jopasuror...*

41.6.1 Në përfundim të hetimit, Komisioni i kërkoi shpjegime bindëse subjektit për këtë rezultat të hetimit.

41.6.2 Subjekti ka shpjeguar se: *“Nuk jemi para shkeljeve të rënda procedurale, pasi siç ka konstatuar shumica (vendimi Gjykatës së Apelit Vlorë është marrë me shumicë) akti i ekspertimit mund të plotësohet nga Gjykata e Apelit, në parashikim të nenit 467 të Kodit të Procedurës Civile.”* Subjekti ka pretenduar se: *“Edhe në supozim që shkeljet lidhur me aktin e ekspertimit të konsideron shkelje të rënda, ato nuk mund të bien mbi mua, pasi kam qenë gjyqtare në pakicë.”*

41.6.2.1 Konstatohet nga procesverbali i seancës gjyqësore datë 14.10.2008 (faqe 39 e fashikullit të gjyqimit), se zonja Gjoka ka qenë gjyqtare në pakicë sa i përket kryerjes së ekspertimit, lidhur me vlerësimin e dëmit shëndetësor shkaktuar.

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019, drejtuar KLGJ-së dhe Ministrisë së Drejtësisë.

41.6.3 Edhe sa i përket rrëzimit të kërkesës për ndryshimin e shkakut ligjor të padisë, që Gjykata e Apelit e ka konsideruar shkelje të rëndë procedurale, kjo nuk është e vërtetë, pasi siç rezulton nga vendimi i ndërmjetëm i arsyetuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, datë 21.10.2008 (faqe 41 e fashikullit të gjykimit), gjykata ka arsyetuar që nuk jemi para ndryshimit të shkakut ligjor të padisë, pasi paditësi ka saktësuar bazën ligjore të padisë ka shtuar nenet 608, 625, 640, 641, 643 të Kodit Civil, të cilat nuk ka të bëjnë me shkakun ligjor të padisë, pasi këto dispozita nuk ndryshojnë shkakun ligjor të padisë, por vetëm e kanë qartësuar atë⁴³.

42. Analiza e gjetjeve: Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (1) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (2) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore në KLD.

i. Aftësitë profesionale

42.1 Njohuritë ligjore: Referuar raportit konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka njohuri për analizën e veprës penale lidhur me fajësinë e autorëve të akuzuar dhe në arsyetim i kushton rëndësi të gjithë elementëve të veprës penale dhe analizës së provave, si dhe ndalet me kujdes tek dënimi penal. Zbaton me korrektesë procedurën e gjykimit të shkurtuar.

42.2 Arsyetimi ligjor: Nga vëzhgimi i akteve të sipërpërkruara arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka aftësi të mira në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila paraqitet e thjeshtë dhe e kuptueshme. Në dispozitivin e vendimit disponohet për kërkimet kryesore rreth objektit të çështjes, për llojin dhe masën e dënimit dhe mënyrën e ekzekutimit të tij, për shpenzimet e përlllogaritura gjyqësore, për të drejtën dhe afatin e ankimit, për datën dhe vendin e shpalljes së vendimit. Nuk ka asnjë vendim të cenuar nga gjykatat më të larta për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimit. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, tek të cilat nuk mungon arsyetimi, duke treguar shkakun dhe bazën ligjore.

ii. Aftësitë organizative

42.3 Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë: Subjekti i rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 - 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier për afër 10 muaj e pjesën tjetër në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Konstatohet se ngarkesa e saj sasiorë ka qenë dukshëm mbi standardin sasior në të dyja gjykatat ku ka punuar gjatë periudhës së rivlerësimit.

42.4 Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore: Referuar raportit konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje shpejt, përmes vendimeve formale për caktimin e

⁴³ Subjekti ka bashkëlidhur si provë fashikullin e gjykimit që i përket vendimit nr.*** datë 13.11.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

seancës gjyqësore. Ajo zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve gjer në dhënien e vendimit përfundimtar. Për çdo kërkesë apo hap procedural, merr rregullisht mendimin e të dyja palëve në gjykim. Disponon me vendime të ndërmjetme të arsyetuara për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit. Ajo ka respektuar të drejtën e palëve për të siguruar mbrojtësin në proceset gjyqësore të vëzhguara.

42.5 Aftësia për të administruar dosjet: Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta, të plota dhe të administruara në dosje në mënyrë kronologjike.

iii. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

42.6 Etika në punë: Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë vërehet se, nga ana e subjektit të rivlerësimit është përmbushur me besnikëri disiplina dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve të tij, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke ruajtur të pastër figurën e gjyqtarit. Për subjektin përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

42.7 Integriteti: Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

42.8 Paanësia: Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna që të jetë kërkuar përjashtimi i saj nga gjykimi i çështjeve. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e tij si edhe nuk janë konstatuar raste që ai të ketë cënuar të drejtat e palëve dhe të viktimave. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Irena Gjoka nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me konceptin e gjykatës së paanshme.

iv. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

42.9 Aftësitë e komunikimit: Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër, është konstatuar se komunikimi ka qenë i qartë dhe i rregullt. Gjuha e përdorur në seancë gjyqësore dhe në akte tek 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

42.10 Aftësia për të bashkëpunuar: Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

42.11 Gatishmëria për t'u angazhuar: Për shkak të funksionit të gjyqtarës të shkallës së parë që kryen, ajo i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 18 trajnime nga Shkolla e Magjistraturës. Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 29 ditë të formimit vazhdues

për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimit ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarës të shkallës së parë në çështjet civile e penale.

🌟 Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

43. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të kryer nga KLGJ-ja dhe dokumentacionin bashkëlidhur tij; (ii) vlerësimin të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese; (iii) kriterëve të vlerësimin të parashikuara në ligjin 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

43.1 Komisioni, me qëllim të vlerësimin të veprimtarisë etike dhe profesionale verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavaruar 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimin, 5 dosjet penale të përzgjedhura me short si edhe të dhënat nga burimet arkivore të KLD.

43.2 Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLGJ-ja, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimin, 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor si dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

❖ Denoncimet e publikut të depozituara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit

44. Për subjektin e rivlerësimin Irena Gjoka janë administruar tre denoncime të paraqitura pranë Komisionit, përkatësisht nga shtetasit M.H., J.Dh., dhe B.B.

44.1 Pas analizimit të dokumentacionit të administruar, për shkak të këtyre denoncimeve, rezulton se nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimin.

Konkluzione për kriterin e vlerësimin profesional

45. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimin, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

45.1 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimin ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

45.2 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimin ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimin në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimin, konkludon se:

- i. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe;
- iii. subjekti ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 26.2.2020

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Genta TAFA (BUNGO)
Relatore

Sekretare gjyqësore
Fiorela MANDRO